

PROCESVERBAL 22/2023

I mbajtur me rastin e takimit të 10 (dhjetë) të rregullt për vitin 2023 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 22.11.2023 duke filluar nga ora 9:30.

Rend dite

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;

3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshimin e emërimit të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronës;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-4813 të datës 27.06.2013;

5.Të ndryshme;

Takimin e hapi kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike;

Avni Bytyqi - bëhet fjalë për lokalin që është te banesa e gjelbërt.Komuna ka arrit që atë lokal ta regjistroj në emër të Komunës dhe ne i kemi procedurat që ta japim në shfrytëzim përmes ankandit publik për periudhën prej 1 deri 15 vjet.

Kryesuesi - pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 2.

Aprovohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshimin e emërimit të shkollave sipas emrave aktual në regjistrin e pronës;

Avni Bytyqi - bëhet fjalë për shkollat të cilat kanë qenë të emërtuara në sistemin e mëparshëm ish jugosllav.Shkollat tash kanë emërtim të ri të cilat janë emërtu sipas vendimit të sekretarit të Ministrisë së Arsimit dhe tani duam ti kthejmë edhe pronat në emër të shkollës,pra me emërtim shqiptar.

Doruntinë Zenelaj - a ka edhe probleme tjera pronësore apo përfundojnë me këtë?

Avni Bytyqi - ato që kanë konteste gjyqësore,ne nuk i prekim.Është vetëm për ato shkolla për të cilat prona është në emër të ish sistemit jugosllav.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Aprovohet pika 3.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-4813 të datës 27.06.2013;

Avni Bytyqi - bëhet fjalë për plotësim-ndryshimin e vendimit të 2013-tës kur Komuna e ka marrë për me këmbë pronën publike në pronë private për interes të përgjithshëm,për zgjerimin e rrugës që shkon për Delloc. Zyryari ligjor tutje jep sqarime.

Nazim Shabanaj - muajin e 8 nuk kemi mbajtur mbledhje.

Avni Bytyqi - Në muajin gusht nuk kemi mbajtur mbledhje as të Komitetit për Komunitete dhe as KPF.Kemi mbajtur vetëm një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Aprovohet pika 4

Pika 5. Të ndryshme;

Kryesuesi - po ju njoftoj që ka dal konkursi për bursa dhe gjithë anëtarët që i përfaqësojnë komunitetet është mirë ti njoftojnë nxënësat e shkollave të mesme dhe studentët.

Takimi përfundoi: 09:45